

*Përgjegjës/Spektori i Mbrojtjes Kibernetike, Drejtoria e Analizës së Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.*

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 9880, datë 25.02.2008, "Për nënshkrimin elektronik" i ndryshuar, ligjit nr. 107/2015 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara", i ndryshuar, ligjit nr.2/2017 "Për Sigurinë Kibernetike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.141, datë 22.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe punonjësve në disa institucione të administratës publike", vendimit të Këshillit të Ministrave nr.763, datë 12.12.2022 "Për caktimin e masës së shtesës për natyrë të veçantë pune për drejtorin e përgjithshëm dhe nëpunësit në njësitë teknike të përmbajtjes së AKCESK", urdhrin të Kryeministrit nr. 32, datë 16.03.2023 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike", Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Përgjegjës/Spektori i Mbrojtjes Kibernetike, Drejtoria e Analizës së Sigurisë Kibernetike, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.**

#### **DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:**

- Vlerëson dhe vërteton arkitekturën e rrjetit bazuar në modelet dhe standardet më të mira të sigurisë;
- Vlerëson konfigurimet e një sistemi bazuar në praktikën e njohura dhe standardet e sigurisë;
- Koordinim me ekipin "Red Team", për të analizuar rezultatet e skanimeve të realizuara nga këto të fundit;
- Koordinohet me ekipin "Red Team", për të realizuar mundësinë e ngritjes së një infrastrukture në laborator, për testimet e sigurisë mbi këto infrastrukture;
- Analizon ndërhyrjet në rrjete të raportuara nga ekipet e monitorimit;
- Ndihmon në përmirësimin e planit për reagimin ndaj incidenteve;
- Zhvillimi i skenarëve të mundshëm të sulmeve të realizuara, në bashkëpunim me ekipet e tjera;
- Analizimi i log të mara nga sistemet SIEM, kur është e nevojshme për kryerjen e analizave, në raste incidentesh;
- Bashkëpunon ngushtë me ekipet e tjera të institucionit, për të krijuar një raport të qartë të problemeve të sigurisë në infrastrukturën, për të cilat janë realizuar testimet;
- Kryen me përpikëri detyrat e dhëna nga drejtuesi dhe në përputhje me procedurat dhe rregulloren e institucionit;
- Merr pjesë në hartimin e metodologjisë kombëtare të vlerësimit të riskut kibernetik, në bashkërendim me drejtoritë e tjera të Autoritetit;
- Merr pjesë në vlerësimin e riskut kibernetik në infrastrukturën e informacionit dhe asetet e tyre, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e sistemeve të monitorimit;

- Merr pjesë në identifikimin dhe analizën e riskut të aseteve në infrastrukturat e informacionit dhe në transmetimin tek infrastrukturat, me qëllim marrjen e masave për reduktimin e riskut;
- Përpunon dhe administron të dhënat statistikore në lidhje me analizën e riskut në infrastrukturat e informacionit;
- Mbledh, analizon dhe përpunon në mënyrë të vazhdueshme informacione mbi zhvillimin e indikatorëve dhe statistikave të sigurisë kibernetike me qëllim identifikimin e trendeve, modeleve dhe kërcënimeve potenciale kibernetike.

## **KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT**

**Arsimi:** Niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”, në Teknologji Informacioni/ Inxhinieri Kompjuterike/ Inxhinieri Informatike/ Inxhinieri Telekomunikacioni/ Inxhinieri Elektronike/ Shkenca Kompjuterike/ Informatikë Ekonomike.

**Përvoja:** Të ketë të paktën 3 vjet përvojë pune në profesion, nga të cilat jo më pak se 2 vjet përvojë në sektorët që trajtojnë dhe menaxhojnë incidentet kibernetike.

## **FUSHA E NJOHURIVE:**

Kandidatët do të intervistohen mbi fushën e njohurive si më poshtë:

- Njohuritë në fushën e sigurisë kibernetike, e lidhur kjo me detyrimet e autoritetit për realizimin e politikave dhe programeve lidhur me këtë fushë;
- Aftësisë për të realizuar objektivat teknik, për të simuluar sulmet dhe për të analizuar informacionet (*loget*), risqet dhe ndjekur masat e kundërmasat për mbrojtjen;
- Njohuritë në vlerësimet e rrezikut të sigurisë së informacionit. Njohuri të mira në gjuhët kompjuterike (programim);
- Njohuritë në Penetration Testing: Kali linux, Social Engineering, Malware, SIEM, Threat Intelligence, Digital Forensics, Ethical Hacking, Sql Injection Attacks, Mitre Attack etj.;
- Njohuri rreth implementimit të masave të sigurisë ISO 27001.

Aftësi për të:

- Teknikat e mbrojtjes kibernetike dhe aplikacioneve që përdoren për këtë qëllim; specialitetet brenda fushës së caktuar profesionale;
- Ofruar drejtim teknik; identifikuar dhe qartësuar çështje e dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale; koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë e vartësve dhe përdorimin e burimeve;
- Të disponojë certifikime në fushën e sigurisë kibernetike lidhur me proceset: Digital Forensics, Ethical Hacking, Comptia Security+ etj.;
- Njohuri në Penetration Testing: Kali linux, Social Engineering, etj.;
- Njohuri të mira në gjuhët kompjuterike (programim);
- Përbën avantazh pajisja me certifikime profesionale: Certifikatë në administrim rrjetash, menaxhim sistemesh: IT security (CompTia Security+), Malware Analysis,

Digital Forensics, pjesëmarrje në trajnime për rritjen e kapaciteteve mbi mbrojtjen ndaj sulmeve Ransomware, pjesëmarrje në Cyber Ranges dhe Cyber Drills;

- Aftësi shumë të mira analize, organizimi, komunikimi dhe prezantimi;
- Të njohë mirë gjuhën angleze.

## **PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (III-2)**

### **PARAQITJA E DOKUMENTEVE:**

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 26.07.2023, ora 16:30, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Kati I, Tiranë ose në adresën e e-mailit: [burimet.njerezore@cesk.gov.al](mailto:burimet.njerezore@cesk.gov.al), këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim;
- CV (sipas formatit europass në gjuhën shqipe);
- Fotokopje të diplomave që disponon dhe listës së notave;
- Diplomat e përfunduara jashtë vendit duhet të shoqërohen edhe me dokumentin e njohjes nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja;
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- Të paktën një letër rekomandimi.

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.